

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Cenaj & Lazaj Law Firm” shpk**

Sot, më datë 22.01.2024, ne, themeluesit,

- a) Artens Lazaj, atësia Flamur, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit ID me numër personal J50407108Q, dhe numër letërnjoftimi 038848867, i datëlindjes 07.04.1995, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë 804320082, Nd.12, H.1, Ap.12, Sarandë, 9701; madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- b) Marko Cenaj, atësia Kasëm, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit ID me numër personal J70329073N, dhe numër letërnjoftimi 033388782, i datëlindjes 29.03.1997, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Bilal Sina 03910020, Nd.1, H.1, Farkë, Selitë; madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme:

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **“Cenaj & Lazaj Law Firm” shpk.**
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) këshillim ligjor të personave fizikë dhe juridikë;
 - b) përfaqësim në procese penale, civile, administrative, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;
 - c) hartim të akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) veprime të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - e) ushtrim i profesionit të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, mbrojtja e interesave të ligjshme të çdo shtetasi në tregun e pasurive të paluajtshme, nëpërmjet ndërmjetësimit të veprimeve juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to;

- f) lidhje të kontratave të ndërmjetësimit me persona fizike ose juridike, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4 **Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në Tiranë, lagjia "Ali Demi", Bulevardi "Bajram Curi", me Nr 7/229-2-12, zona kadastrale 8150, Vol 10, faqe 118, njësi me sipërfaqe 66 m², sipas kontratës së qirasë Nr 3944 rep, Nr 2365 kol, datë 23.12.2023.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10 000 (dhjetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në dy (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Artens Lazaj, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (pesëmijë) Lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë
 - b) Ortaku themelues Marko Cenaj, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (pesëmijë) Lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6 **Administratori**

- 1) Administratore të shoqërisë emërohen:
 - a) Artens Lazaj, atësia Flamur, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit ID me numër personal J50407108Q, dhe numër letërnjoftimi 038848867, i datelindjes 07.04.1995, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, me adresë 804320082, Nd 12, H.1, Ap 12, Sarandë, 9701, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

- b) Marko Cenaj, atësia Kasëm, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit ID me numer personal J70329073N, dhe numër letërnjoftimi 033388782, i datelindjes 29.03.1997, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Bilal Sina 03910020, Nd 1, H.1, Farkë, Selitë, me afat emerimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emerimit.


Neni 7
Baza Ligjore


- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Per sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligj tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

- 1) Te gjitha mosmarrëveshjet qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do te zgjidhen nËpËrmjet organeve te posaçme te njohura nga ligji.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Cenaj & Lazaj Law Firm"

Marko Cenaj

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Artens Lazaj

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)